



VENDIM

Nr. 148 Datë 07.12.2011

PËR

**PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE TË SHITJES ME PAKICË TË
ENERGJISË ELEKTRIKE PËR KONSUMATORËT TARIFORE PËR
PERIUDHEN E TRETË RREGULLATORE**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 26 të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, neneve 20, 21 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Vendimit nr. 80, datë 26.06.2008, “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me pakicë të energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.12.2011, pasi shqyrtoi aplikimin e ÇEZ SHPËRNDARJE sh.a për përcaktimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tarifore,, për periudhën e tretë rregullatore dhe relacionin e grupit të punës,

Vendosi :

1. Miratimin e çmimeve të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për konsumatorët tariforë për periudhën e tretë rregullatore, (vitet 2012 – 2014) sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit për njoftimin e ÇEZ Shpërndarje sh.a.

Ky vendim hyn në fuqi në datën 01.01.2012.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI

Tarifat e shërbimeve dhe të shitjes me pakicë të energjisë elektrike për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014

| Niveli i Tensionit | Kategoritë e Konsumatoreve | Viti 2012-2014 | |
|---|---|------------------|-------------------------------------|
| | | Cmimi (leke/kWh) | Cmimi i energjisë në pik (leke/kWh) |
| TENSIONI I MESEM | Kliente të furnizuar në 35 kV | | |
| | Industri | 8.50 | 9.78 |
| | Tregëti & shërbime | 8.50 | 9.78 |
| | Bujqësi | 8.50 | 9.78 |
| | Te tjerë | 8.50 | 9.78 |
| | | | |
| | Kliente të furnizuar në 20/10/6 kV | | |
| | Industri | 9.10 | 10.47 |
| | Tregëti & shërbime | 10.00 | 11.50 |
| | Furra buke, prodhim mielli | 7.10 | 8.17 |
| | Bujqësi | 8.70 | 10.01 |
| | Te tjerë | 9.70 | 11.16 |
| Buxhetore | 11.50 | 13.23 | |
| TENSIONI I ULET | Kliente të furnizuar në TU | | |
| | Industri | 10.50 | 12.08 |
| | Tregëti & shërbime | 12.20 | 14.03 |
| | Furra buke, prodhim mielli | 7.60 | 8.74 |
| | Bujqësi | 10.50 | 12.08 |
| | Te tjerë | 12.00 | 13.80 |
| | Buxhetore | 14.00 | 16.10 |
| | | | |
| | Familjare | | |
| | Bloku I për deri në 300 kWh | 7.70 | |
| | Bloku I dytë mbi 300 kWh | 13.50 | |
| | | | |
| Tarifa fikse e shërbimit për leximin "zero" (leke/muaj) | 200 | | |
| Tarifa për konsumin e energjisë elektrike në ambientet e përbashkëta (shkallë, pompe, ashensor, etj (leke/kWh) | 8.00 | | |
| * Cmimi i energjisë reaktive do të jetë 15% e cmimit të energjisë aktive | | | |

Orari i pik gjatë të cilit do të aplikohet tarifa për energjinë e konsumuar në pik është

- Për periudhën 1 Nëntor – 31 Mars nga ora 18:00 deri 22:00
- Për periudhën 1 Prill – 31 Tetor nga ora 19:00 deri 23:00